

Afet Mamuti, PhD¹

UDC: 347.426.4/.6:340.13(497.7)

**KONCEPTI JURIDIK PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT
JOMATERIAL**

**ПРАВЕН КОНЦЕПТ ЗА НАГРАДУВАЊЕ НА МАТЕРИЈАЛНА
ШТЕТА**

**LEGAL CONCEPT FOR COMPENSATION OF NON-MATERIAL
DAMAGE**

Abstract

Non-material damage is caused at the time of the encroachment of person's personal rights. Non-material damage can manifest itself in the form of physical and mental pain of the person or even in the form of the fear caused. Non-material damage can be caused not only to the natural person, but the same to juridical person, with the exception of personal rights of biologic character, which apply only to natural persons. Based on this, juridical persons also have the right to claim compensation of non-material damages, in cases where their company name, reputation or business secret is violated, which may cause damages in market loss, reduced production, loss of costumers as well as credibility loss in relation with business partners and costumers etc. The Legislation of Northern Macedonia has defined compensation for non-material damage, in case of causing physical pain, mental suffering, reduction of vital activity, disfigurement, reputation encroachment, honor, freedom, death of relatives as well as fear. If the court if notice that the circumstances of the case, the level of pain and fear and its duration

¹ Faculty of Law, University of Tetova, Republic of Macedonia. Email: afet.mamuti@unite.edu.mk

justify this, will judge it reasonable compensation with money, regardless of the material damage, even in its absence. With the amendments and supplements to the Law on Obligational Relationships in 2008, foresees that all natural and juridical persons, except the protection of property rights, to be able to protect their personal rights. As personal rights by law are: the right to life, the right for physical and mental health, honor, reputation, dignity, personal name, privacy of personal and family life, freedom, intellectual creativity and other personal rights.

Keywords: non-material damage, compensation, physical pain, mental suffering, fear

Koncepti juridik i dëmit jomaterial

Shumica e sistemeve juridike të Evropës vonë e kanë njohur shpërblimin e dëmit jomaterial. Ky koncept në Maqedoninë e Veriut ka qenë i njohur që nga legjislacioni civil i periudhës së mbretërisë SKS, të para Luftës së Dytë Botërore, pjesë e së cilës ka qenë dhe Maqedonia e Veriut. Këto norma kanë qenë të bazuara në Kodin Civil të Austrisë të vitit 1909. Kjo e drejtë realizohet përmes përdorimit të padisë *actio iniuriarum*, që aplikohet jo vetëm në rastet e shkeljeve të dinjitetit dhe reputacionit të individit, por edhe me rastin e cenimit të integritetit fizik, sa herë që shkaktesa i dëmit sillet në mënyrë të gabuar dhe me faj.² Për dallim nga dëmi material që vjen si rezultat i dëmtimit të të mirave materiale, dëmi jomaterial rezulton nga cenimi i të drejtave jomateriale, siç janë: cenimi i lirisë, privatësisë, nderit, shkaktimi i dhimbjeve fizike, psikike apo të frikës, përkatësisht nga cenimi i të mirave personale të njeriut që i garanton rendi juridik. Që nga shekulli i XIX, legjislacionet dhe praktika gjyqësore e shumicës së vendeve pranojnë shpërblimin e dëmit jomaterial, në bazë të rregullës së përgjithshme se çdo dëm duhet të shpërblehet, nëse në vetvete ka disa karakteristika të dëmit. Disa autorë, gjatë shek. XX mendonin se “dëmi jomaterial ekziston gjithmonë kur kompensimi me para nuk është në gjendje ta kompensojë në mënyrë adekuate dëmin dhe ta vlerësojë objektivisht, pasi paratë në raport me dëmin e shkaktuar nuk mund të plotësojnë funksionin e tyre

² Reinhard Zimmermann, “THE LAW OF OBLIGATIONS: Roman Foundations of the Civilian Tradition”, Published in the United States by Oxford University Press Inc., New York, 1996, f. 1050-1052

si ekuivalent.³ Kështu edhe neni 189 i LMD parasheh që për shkakimin e dhimbjeve fizike, për vuajtjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, shëmtimit, cenimit të reputacionit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, vdekjen e ndonjë të afërmi si dhe frikës, gjykata nëse vëren se rrethanat e rastit, veçanërisht forca e dhimbjeve dhe frikës dhe kohëzgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë kompensim të arsyeshëm me para, pavarësisht kompensimit të dëmit material, madje edhe në mungesë të tij. Me ndryshimet dhe plotësimet e LMD në vitin 2008, parashihet që të gjithë personat fizik dhe juridik, përveç mbrojtjes së të drejtave pasurore, kanë të drejtën edhe në mbrojtjen e të drejtave personale. Si të drejta personale në bazë të ligjit konsiderohen: e drejta për jetë, e drejta për shëndet trupor dhe mental, nderi, reputacioni, dinjiteti, emri personal, privatësia e jetës personale dhe familjare, liria, krijimtaria intelektuale dhe të drejta tjera personale.

Në gjitha vendet e Evropës dhe vendet e tjera me demokraci në zhvillim ka një tendencë të zgjerimit të konceptit të dëmit jomaterial, duke përfshirë shkeljen e çdo të drejte subjektive, nisur nga të drejtat themelore të njeriut, siç është e drejta për jetë, reputacion dhe emër të mirë, nderin, pacenueshmërinë e shëndetit fizik dhe psikik dhe private-sinë. Maqedonia e Veriut si vend që aspiron të jetë anëtare e Bashkimit Evropian, në vazhdimësi bën harmonizimin e legjislacionit të vendit me atë të BE-së, dhe pikërisht këtu synohet edhe zgjerimi i normave për shkakimin e dëmit jomaterial, në dispozitat e Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve të Maqedonisë, që të përfshihen edhe rrethanat që pamundësojnë ngritjen dhe avancimin në profesion apo karrierë, paaftësinë për të lindur, humbjen e aftësisë seksuale etj.

Maqedonia e Veriut nuk ua njeh të drejtën e zhdëmtimit personave, për rastet që nuk janë paraparë në mënyrë taksative në nenin 189 të LMD-së apo me ndonjë dispozitë të ndonjë ligji tjetër, edhe pse shpeshherë gjykatësit mundohen që situatat faktike t'ia përshtatin asaj pjese të ligjit që parasheh “për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor”, që të mund të realizon të drejtën në dëmshpërblim pala.

Dëmi moral, cenon të mirat personale të të dëmtuarit duke zvogëluar aktivitetin njerëzor, duke i shkakuar shëmtim, vuajtje, frikë, vdekje të të afërmeve e të tjera. Rrethanat e rastit të shkakimit të dëmit, veçanërisht lartësia (intensiteti) e dhembjeve dhe frikës dhe kohëzgjatja

³ François Givord, “La Reparation du prejudice moral” I thèse pour le doctorat présentée et soutenue le lundi 14 novembre 1938, à 14 h. Université de Grenoble, Dalloz, Paris

e tyre janë vendimtare në përcaktimin e llojit të dëmit moral dhe vëllimit të tij. Edhe në rastet kur ndonjë personi i vdes një i afërm, konsiderohet se për personat e mbijetuar të familjes së ngushtë, përfshirë bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit, u është shkaktuar dëm jomaterial (moral). E njëjta gjë ndodhë edhe në rastet kur vëllezërit dhe motrat e të dëmtuarit, kanë qenë në bashkësi të përhershme jetësore, me çka konsiderohet se edhe atyre i'u është shkaktuar dëm moral. Dëmi moral do të shkaktohet edhe në rastet e shkaktimit të invaliditetit të rëndë të ndonjë personi, me të cilin përveç dhembjeve fizike dhe psikike që krijohen për të dëmtuarin, ky rast gjithashtu krijon dhe dhembje psikike bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve të të dëmtuarit i cili ka përjetuar invaliditet të rëndë. Me fjalë të tjera, mund të themi se dëmi moral shkaktohet si pasojë e cenimit të integritetit psikofizik të personit që gëzon në vetvete një mbrojtje juridike, me cilësinë e një të mire materiale, pavarësisht nga zotësia e personit për të krijuar pasuri, ose vlera shkëmbimi. Ky dëm vlerësohet mbi intensitetin e “vuajtjes” që përjeton individi dhe nga “humbja” që ai pëson. Këtu duhet të kemi parasysh se intensiteti me të cilin çdo individ e përjeton një ngjarje është e ndryshme dhe gjithashtu i ndryshëm është edhe perceptimi që mund të ketë secili mbi atë që është “vuajtje” dhe “humbje” për të. Por nga ana tjetër është shumë e vështirë dhe ndoshta e pamundur që të bëhet një përkufizim përfundimtar dhe gjithëpërfshirës i asaj se çfarë do ta përbëjë dëmin jo-material.

Por dëmi material dhe ai jo-material apo moral nuk janë dy kategori rreptësisht të ndara nga njëra-tjetra. Shpesh hasemi në praktikë edhe me situata kur dëmi që i është shkaktuar palës i përmban të dy elementet, p.sh. humbja e një të afërmi, përveç dhimbjes shpirtërore që shkakton mund të ketë edhe pasoja në humbje ekonomike kur i ndjeri ka qenë kontribuuesi ekonomik në familje. Apo në rastet e dëmtimit të imazhit që mund të ndikojë negativisht në zhvillimin në karrierë dhe gjetjen e një vendi pune, atëherë në mënyrë direkte ka humbje monetare, dëm material. Këto situata mikse në fakt përfshijnë një zonë shumë të gjerë në ndarjen klasike dypolare të llojit të dëmit në material dhe jo-material. Dëmi jomaterial, si detyrim për shpërblim mund të figurojë paralelisht me detyrimin për shpërblim të dëmit material, por mund të figurojë edhe si i vetëm në vendimin gjyqësor. Teoria shkencore dhe legjislationet e vendeve të ndryshme përdorin emërtime të ndryshme për dëmin jomaterial. Emërtimet ndonjëherë kanë refleksion të drejt-përdrejtë gjatë përshtatjes së këtyre shprehjeve nga gjuhë të huaja, kurse

ndonjëherë është kushtëzuar nga depërtimi i neologjizmave nga formulimet ligjore të ligjeve të huaja në sistemin juridik konkret: dëmi jomaterial; dëmi jo pasuror; dëmi moral; dëmi jo në para; dëmi ideal; dëmi për shkak të vdekjes; lëndimi trupor; dëmtimi i shëndetit.⁴

Mënyra e shpërblimit të dëmit jomaterial dhe procedura

Shpërblimi i dëmit të shkaktuar, shpeshherë përfshin përveç dëmit material edhe dëmin jomaterial, apo moral. Gjithashtu, ngjashëm sikurse për personat fizik, kjo e drejtë u garantohet edhe personave juridik, me përjashtim të të drejtave personale të karakterit biologjik, të cilat vlejnë vetëm për personat fizik. Kjo, pasi, në praktikë ndodhë shpesh herë që edhe personave juridik t'u cenohet emri i mirë, reputacioni apo sekreti afarist. Numri më i madh i sistemeve juridike parashikojnë që, shpërblimi i dëmit jomaterial që ka pësuar njeriu nga dëmi i shkaktuar, gjithmonë duhet gjykuar në vlerë monetare. Megjithatë, kur flasim për dëmin jomaterial, në përgjithësi një numër i konsiderueshëm i sistemeve juridike, kompensimin me para e parashohin si përjashtim, pasi sipas tyre ky lloj kompensimi na çon deri në komercializim të personalitetit të njeriut dhe manipulim me të mirat personale të njeriut, pamundësinë e kompensimit të drejtë, pasi është e pamundur që të vlerësohet në mënyrë precize lartësia e intensitetit të dhimbjes.⁵ Mirëpo, përkundër kësaj, në përgjithësi dominoi mendimi se është më e drejtë që të kompensohet dëmi jomaterial se sa mos të kompensohet, pasi në këtë mënyrë, kjo do të ishte një satisfaksion për të dëmtuarin. Ekzistojnë raste kur për shpërblim të dëmit jomaterial, aktgjykimi i gjykatës parashihet detyrimin për shkaktuesin e dëmit që ta publikon vendimin e gjykatës me të cilën shpallet fajtor, apo të deklaron publikisht se e tërheq deklaratën me të cilën është shkaktuar dëmi dhe të kërkon falje publike. Kërkimi i faljes apo tërheqja e deklaratave për shpifje dhe fyerje, duhet të publikohen në të njëjtin vend dhe kohë dhe në vëllim të njëjtë sikurse deklaratat e cila kundërshtohen.⁶ Në qoftë se cenimi i të mirave jomateriale përmes shpifjes dhe fyerjes është bërë përmes mjeteve të

⁴ Marjana Pop-Taleska, "Dëmet ndërkombëtare bazuar në kartonin e gjelbërt", Sigurimi Vardar sh.a., Dëmi jomaterial, Revistë shkencore "AKADEMIK" - Shkup, tetor 2006, f. 18

⁵ Aleksandar Nikollovski, Stopansko pravo so osnovi na pravoto, Shkup, 1984. f. 171

⁶ Paragrafi 2 i nenit 13 të "Ligjit për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje", Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr.143\2012, datë 14.11.2012

informimit publik apo sistemit kompjuterik, pala e dëmtuar ka të drejtë që të kërkojë nga shkaktuesi i dëmit që brenda afatit prej shtatë ditësh dhe më së shumti një muaj nga publikimi i deklaratës, që të publikojë sqarimin apo përmirësimin e deklaratës për shpifje dhe fyerje, me qëllim që të mos iniciohet procedurë gjyqësore përmes padisë. Një falje mund të ketë rëndësi në shumë mënyra. Në literaturë mbizotëron bindja se falja ka rëndësi personale për viktimën. Subjektivisht, një falje mund ta ndihmojë viktimën në rimëkëmbjen dhe rivendosjen e marrëdhënies së mirebesimit. Objektivisht, rëndësia e një kërkim faljeje mund të shihet si shfaqësim për botën në përgjithësi për të drejtat e shkelura të viktimës.

Akti i dhënies së faljes mund të ketë rëndësi si një mjet për të ruajtur dhe përforcuar kohezionin social. Sipas nenit 16 të Ligjit për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje, shpërblimi i dëmit jomaterial për fyerje do të gjykohet vetëm nëse shkaktuesi i fyerjes nuk kërkon falje dhe nuk e tërheq deklaratën për fyerje dhe nëse e përsërit fyerjen edhe pas vendimit gjyqësor që e ndalon këtë lloj të fyerjes. Kur flasim për dëmin jomaterial të shkaktuar nga aksidentet automobilistike, duhet të kemi parasysh se ky lloj shpërblimi i dëmit paraqet një kategori të re në vendin tonë dhe gjen zbatim të zgjeruar në dekadën e fundit. Kështu, në mënyrë të ngjashme edhe LMD-ja dhe praktika gjyqësore në Maqedoni, parimisht e pranojnë kompensimin me para për dëmin jomaterial. Kështu, në paragrafin 1 të nenit 189 të LMD-së thuhet: “Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, shëmtimit, cenimit të personalitetit, nderit, lirisë apo të drejtave personale, të vdekjes së personit të afërm, si dhe për frikën, gjykata, nëse konstaton se rrethanat e rastit, sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material apo nga mos kompensimi i tij”.

Kushtet për shpërblimin e dëmit jomaterial

Me shpërblim të dëmit jomaterial nënkuptojmë zhdëmtimin e subjektit të dëmtuar, në rastet e cenimit të të mirave personale. Sipas rregullave të së drejtës objektive, cenimi i të mirave pasurore, i personalitetit ose i integritetit fizik dhe psikik të njeriut, ekziston kur personi me veprimin ose me mosveprimin e tij, ia cenon tjetrit korpusin e të drejtave juridikisht të mbrojtura. Si kushte me rëndësi, për shpërblimin e dëmit jomaterial janë: a) që dëmi i shkaktuar t’i cenojë vlerat

personale të njeriut, b) të ekzistojë faji i dëmtuesit, c) të ekzistojë intensiteti dhe kohëzgjatja e përjetimit të dhembjeve dhe d) gjendja materiale e dëmtuesit.⁷

Autori i dëmit, me rastin e shkakimit të dëmit jo-material, mund të përgjigjet edhe sipas rregullave të përgjegjësisë subjektive edhe asaj objektive. Rastet më të shpeshta të përgjegjësisë objektive nga shkaktimi i dëmit jomaterial lindin kryesisht kur dëmi shkaktohet nga vetura në lëvizje, pasi vetura në lëvizje, sipas rregullave të së drejtës, konsiderohet send me burim rreziku të shtuar. Shpërblimin e dëmit jo-material, respektivisht lartësinë e tij e cakton gjykata në procedurë civile, mirëpo organet e jurisprudencës me këtë rast e kanë më të vështirë të caktojnë vlerën e saktë të kompensimit, për dallim tek caktimi i lartësisë së shpërblimit të dëmit material, pasi ky shpërblim duhet të shërbejë edhe si satisfaksion për palën e dëmtuar. Me rastin e vendosjes për kërkesën për kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata duhet të mbajë llogari për vlerën që paraqet e mira që është shkelur dhe të qëllimit, të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë për shtat tendencave që nuk janë në harmoni me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.⁸ Personat që mund të përfitojnë nga shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të vdekjes apo invaliditetit të rëndë të personit, në mënyrë taksative janë përcaktuar në nenin 190 të LMD-së. Invaliditeti ekziston kur tek i siguruari, për shkak të ndryshimeve të gjendjes shëndetësore, e cila nuk mund të mënjanohet me terapi me barëra apo me rehabilitim mjekësor, aftësia punuese e të cilit për përherë është zvogëluar për më tepër se gjysma, duke krahasuar me të siguarin që është në gjendje të shëndoshë fizike dhe psikike me përgatitje të njëjtë dhe të ngjashme.⁹ Kështu, në paragrafin 1 parashihet se në rast të vdekjes së ndonjë personi, gjykata mund të gjykojë shpërblim të arsyeshëm për anëtarët e familjes së ngushtë të tij, për shkak të dhimbjeve të tyre shpirtërore (bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve).¹⁰ Kjo dispozitë, në mënyrë të

⁷ Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, f. 202

⁸ Neni 189, pika 2, i Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. . 07-761/1, datë 18.02.2001

⁹ Neni 38 i Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 98 të datës 01.08.2012

¹⁰ Sipas paragrafit 4 të nenit 190 të po këtij ligji edhe bashkëshorti-ja jashtëmartesorë mund të fitojë të drejtën për shpërblim të dëmit jomaterial, në qoftë se në mes tij dhe bashkëshortes jashtëmartesore të vdekur ka ekzistuar bashkësi jetese e përhershme.

ngjashme do të zbatohet edhe në rastet kur bëhet fjalë për fëmijë të lindur nga bashkësia jashtëmartesore. Në paragrafin 2, sqarohet se e drejta për të kërkuar shpërblim të dëmit jomaterial mund tu njihet edhe vëllezërve dhe motrave, në qoftë se ndërmjet këtyre dhe ka ekzistuar për një kohë më të gjatë bashkësia e jetesës. Meqë, në disa raste për shërimin e sëmundjeve apo invaliditetit nevojitet periudhë më e gjatë kohore deri në shërimin e plotë të personin, apo edhe përkundër kësaj, personi të vazhdon të mbetet me invaliditet të përhershëm, i cili po ashtu do t'i shkaktonte vuajtje psikike, Legjislacioni dhe praktika gjyqësore kanë paraparë mundësinë e shpërblimit të dëmit jomaterial edhe për të ardhmen. Kështu, sipas nenit 192 të LMD-së “Gjykata me kërkesë e të dëmtuarit do të gjykojë shpërblim të dëmit të ardhshëm jomaterial në qoftë se sipas rrjedhës normale të gjërave është e qartë se kjo do të vazhdojë edhe në të ardhmen”.

Kërkesat për shpërblim të dëmit jomaterial përkundër që rrjedhin nga cenimi i vlerave morale, të njëjtat mund të kalojnë në trashëgimtar për faktin se me rastin zhdëmtimit ato jepen në formë të vlerës pasurore të caktuara ndaj palës së dëmtuar. Që të ndodh ky kalim i shpërblimit të trashëgimtarët, duhet që e njëjta të jetë pranuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, apo me marrëveshje me shkrim. Në bazë të praktikës gjyqësore, marrëveshja jashtëgjyqësore me shkrim e lidhur ndërmjet palës së dëmtuar dhe shoqërisë së sigurimeve në mënyrë të plotë, zëvendëson vendimin e plotfuqishëm gjyqësor. Kërkesën për zhdëmtim ngjashëm sikurse të drejtën për shpërblim të dëmit që mund ta realizojë personi i dëmtuar, e njëjta kalon tek trashëgimtarët me të gjitha efektet juridike që mund të kishte për vet personin e dëmtuar. Nga e njëjta, trashëgimtari mund të heq dorë, por e njëjta edhe mund të realizohet në rrugë ligjore, përmes ekzekutimit të dhunshëm, po që se shkaktuesi i dëmit nuk e përmbush vet detyrimin në mënyrë vullnetare. Të drejtë për të kërkuar shpërblim të dëmit jomaterial kanë edhe personat juridikë, në rastet kur u cenohet emri i ndërmarrjes, reputacioni apo sekret i afarist, e cila mund të shkaktojë pasoja në humbjen e tregut, rënien e prodhimit, humbjen e klientelës si dhe humbjen e kredibilitetit në raport me partnerët afarist dhe klientët.

Shpërblimi i dëmit jomaterial me para

Shpërblimi i dëmit jomaterial paraqet një nga mënyrat për zhdëmtimin e palës së dëmtuar, për rastet e dëmtimit të të mirave personale. Meqë, janë të rralla, ndonjëherë edhe i pamundur kthimi në gjendjen e mëparshme të shpërblimit të dëmit jomaterial nga dëmi i shkaktuar atëherë zakonisht shpërblimi i këtij dëmi bëhet me të holla. Zhdëmtimi i dëmit jomaterial me të holla nuk bëhet për të riparuar ndonjë cenim të ndonjë vlere pasurore të cenuar, e as për të dënuar shkaktuesin e dëmit, por i njëjti jepet si satisfaksion për personin e dëmtuar. Shpërblimi i dëmit jomaterial jepet pavarësisht shpërblimit të dëmit material. Meqenëse shpërblimi i dëmit material në të holla jepet për rastet kur shkaktohet frika, dhembje fizike apo vuajtje psikike, atëherë, kjo për gjyqtarët paraqet vështirësi me rastin e përcaktimit të saktë të vlerës së dëmit të shkaktuar. Kjo sepse shpërblimi nuk jepet vetëm në mënyrë simbolike, siç ka qenë dikur në të drejtën franceze (një frang), por duhet të paraqesë një shpërblim të drejtë dhe sa më adekuat, në atë mënyrë që do të ndikojë në zbutjen e gjendjes specifike që i është shkaktuar të dëmtuarit.¹¹ Shpërblimi i dëmit jomaterial në të holla mund t'i jepet të dëmtuarit menjëherë, por mund t'i jepet edhe në formë të rentës jetësore. Në praktikën gjyqësore në Maqedoni, aplikohen të dy variantet e zhdëmtimit, varësisht nga rasti konkret. P.sh. në qoftë se nga dëmi i shkaktuar tek personi krijohet lëndim i rëndë trupor,¹² i cili përcillet me vuajtje shpirtërore dhe me zvogëlim të aktivitetit jetësor, atëherë gjyqtari për këtë rast mund të caktojë shpërblimin e dëmit jomaterial ose me dhënien e një shume të të hollave të menjëhershme ose me dhënien në formë të rentës në të holla. Që të përcaktohet për njërin apo për variantin tjetër, gjyqtari, përveç pasojave të rastit konkret, do të merr për bazë edhe atë se cila nga mënyrat do të jetë më me efektive tek i dëmtuari që paraqet vërtet një satisfaksion shpërblim të tërësishëm të dëmit.

¹¹ Më gjerësisht shih Alishani Alajdin, E drejta e detyrimeve-Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2002, f. 571.

¹² Edhe pse ligji nuk e definton “invaliditetin e rëndë”, por në bazë të praktikës gjyqësore të Maqedonisë së Veriut, kjo gjendje krijohet në rastet kur kjo paaftësi për punë dhe për jetë tejkalon 70% të shkallës së invaliditetit.

Rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut

Rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial për shkak të cenimit të të mirave personale, mund të paraqitet në format e mëposhtme:

- a) shpërblim i dëmit jomaterial për shkak të dëmtimit të shëndetit,
- b) shpërblim i dëmit jomaterial për shkak të lëndimit trupor,
- c) shpërblim i dëmit jomaterial për shkak të shkakimit të vdekjes,
- ç) shpërblim i dëmit jomaterial për shkak të shkakimit të frikës,
- d) shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkakimit të shëmtimit,
- e) shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkakimit të dhembjes fizike,
- f) shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkakimit të vuajtjes psikike.

Në pikat “a, b” dhe “c” duhet pasur parasysh se gjatë shkakimit të dëmtimit të shëndetit, lëndimit trupor apo vdekja e njeriut ndodh duke shkakuar edhe dëm material edhe dëm jomaterial. Në këto raste, dëmi material shkaktohet atëherë kur për personin në fjalë (viktimën), nevojitet intervenim mjekësor, barëra, terapi, proteza, shpenzime për shtrim në spital, shpërblim për personin që kujdeset për të dëmtuarin, për transport, apo në rastin e vdekjes, nevojitet blerja e arkivolit, vendit të varrimit, shpenzime për përcjellje derri te varri të personit të vdekur etj. Gjithashtu, dëm material shkaktohet edhe në rast të zvogëlimit të aftësisë për punë, qoftë të përhershme apo të përkohshme, me çka personi humb aftësinë për punë dhe nuk mund të realizojë të ardhura. Mirëpo, përkundër dëmit material, pasoja në këto raste paraqitet edhe në formë të dëmit moral.

Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të dëmtimit të shëndetit

Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të dëmtimit të shëndetit paraqet një nga rastet shumë të ndryshme dhe të ndërlikuara të së drejtës së detyrimeve. Legjislacioni i Maqedonisë së Veriut lidhur me dëmtimin e shëndetit përdor shprehjen zvogëlim të përgjithshëm të aftësisë për jetesë. Për domethënien e zvogëlimit të përgjithshëm të aftësisë për jetesë, përdoren shprehjet dhe sinonimet: zvogëlim i aftësisë për jetesë, zvogëlim i kapacitetit vital, zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm

trupor, dëmtim trupor, dëmtim i përgjithshëm trupor, sakatim trupor etj.¹³ Kështu, edhe praktika gjyqësore si burim plotësues i së drejtës civile, përmes vendimit të Gjykatës Supreme ka përcaktuar se: “Zvogëlimi i aftësisë së përgjithshme për jetesë vetëm gjatë kohës së shërimit të lëndimeve trupore, nuk paraqet bazë për shpërblim të dëmit jomaterial për shkak të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme për jetesë. I dëmtuari, ka të drejtën e shpërblimit të dëmit në bazë të kësaj baze, vetëm në qoftë se ekziston zvogëlim i përhershëm i aftësisë së përgjithshme për jetesë.”¹⁴ Aftësia për jetesë ekziston te personi atëherë kur ai është në gjendje të plotësojë nevojat e përgjithshme jetësore. Që të realizohet shpërblimi i dëmit jomaterial, duhet që në mënyrë kumulative të plotësohen këto kushte: të vërtetohet pasoja e dëmtimit të shëndetit, nga dëmtimi i shëndetit të shkaktohet dëm jomaterial në kuptim të shkakut të vuajtjes psikike, nga kjo vuajtje psikike t’i shkaktohet dëm personit të dëmtuar apo çekuilibrim psikik, të ekzistojë lidhja kauzale midis cenimit të shëndetit dhe dëmit të shkaktohet, si dhe duhet t’i parashtruhet kërkesa gjykatës për realizimin e shpërblimit të këtij dëmi.¹⁵

Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të lëndimit trupor

Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të lëndimit trupor ekziston në ato raste kur personit i shkaktohen thyerje të ekstremiteteve, thyerje të brinjëve, dëmtim apo thyerje të boshtit të kurrizit, fraktura të kokës apo plagë të tjera në trup, helmime, me ç’rast tek personi paraqiten dhimbje fizike dhe vuajtje psikike. Lëndimi trupor, sipas nenit 69 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, ekziston atëherë kur tek i siguruari do të shkaktohet humbje, dëmtim më thelbësor apo paaftësi më e theksuar e organeve të caktuara apo pjesëve të trupit që e rëndojnë aktivitetin normal të organizmit dhe kërkon më shumë përpjekje në realizimin e nevojave jetësore, pa marrë parasysh se a shkaktohet apo jo invaliditetet. Invaliditeti i rëndë shkaktohet në qoftë se funksionet jetësore të palës së dëmtuar zvogëlohen mbi 70%. Lartësia e shpërblimit

¹³ Aleksej Duma, Aleksandra Gutevska (mjek në Institutin për mjekësi ligjore dhe kriminalistik, Fakulteti i mjekësisë, Shkup), “Ekspertiza mjeko-ligjore për pasojat e lëndimeve trupore në kuadër të të drejtës civile”, “Dëmi jomaterial”, Revistë shkencore “AKADEMIK” - Shkup, 2006, f. 90

¹⁴ Vendim i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, GZh. Nr391/77, të datës 08.12.1977.

¹⁵ Alishani Alajdin, vep. e cit., f. 557

me para për këtë lloj të dëmit duhet të jetë deri në 60% nga shpërblimi që paguhet për shkaktim të dhimbjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së personit të afërm.¹⁶ Që të ndodhë shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të lëndimit trupor, gjithashtu edhe këtu, në mënyrë kumulative, duhet të plotësohen këto kushte: duhet të shkaktohet dëmtimi trupor, dëmtimi trupor të shkaktojë dhembje fizike ose vuajtje psikike, të ekzistojë lidhja kauzale midis lëndimit trupor dhe vuajtjeve të shkaktuara fizike dhe psikike të të dëmtuarit dhe të ekzistojë subjekti përgjegjës.¹⁷ Përcaktimin për kompensimin e këtij dëmi e bën gjykata, duke u bazuar në vlerësimin e ekspertit gjyqësor, pasi këtu është shumë e rëndësishme që të konstatohet intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike dhe vuajtjeve psikike të personit. Ky dëm jomaterial duhet të shpërblehet pasi me rastin e shkakimit të vdekjes të një anëtarit të afërm të familjes, anëtarëve të tjerë të rrethit të ngushtë të familjes së të vdekurit u shkaktohet vuajtje psikike. Në grupin e anëtarëve të ngushtë të familjes, bëjnë pjesë prindërit, fëmijët dhe bashkëshorti, në qoftë se kanë jetuar në bashkësi të përhershme jete dhe shpërblimi për këtë lloj dëmi i'u takon po të njëjtëve. Në raste të caktuara, këtë lloj të shpërblimit mund ta kërkojnë edhe vëllezërit, motrat, bashkëshorti jashtëmartesor, nëse në mes tyre dhe të vdekurit ka ekzistuar një jetë më e gjatë e përbashkët. Për tu realizuar shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkakimit të vdekjes, duhet të plotësohen këto kushte: të jetë shkaktuar vdekja e të afërmit, vdekja të shkaktojë vuajtje tek të afërmit e tij, të ekzistojë lidhja kauzale midis vdekjes së shkaktuar dhe vuajtjes psikike të shkaktuar, vdekja të jetë shkaktuar me veprim të kundërligjshëm si dhe duhet t'i parashtrahet kërkesa gjykatës për shpërblim të dëmit jomaterial.¹⁸ Në bazë të praktikës gjyqësore të Maqedonisë kemi raste kur njerku fiton të drejtën e shpërblimit të dëmit për dhimbjet shpirtërore, për shkak të vdekjes së thjeshtërit, në qoftë se ndërmjet tyre ka ekzistuar bashkësi jetese e përhershme me lidhje të ngushtë emocionale dhe varshmëri materiale ndaj njëri tjetrit.¹⁹ Po ashtu, edhe gjyshi dhe gjyshja kanë të drejtën në shpërblim të dëmit jomaterial për dhimbjet shpirtërore për

¹⁶ Mirko Zdraveski (anëtar i Komisionit për sigurimin nga përgjegjësia automobilistike), "Kriteret dhe masat për matjen e shpërblimit të dëmit që përcaktohet në bazë të vlerësimit të lirë", Revistë shkencore "AKADEMIK" - Shkup, tetor 2006, f. 211

¹⁷ Alishani Alajdin, vep. e cit. f. 558-559

¹⁸ Alishani Alajdin, vep. e cit., f. 560.

¹⁹ Vendim i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, Rev. nr. 274/93 të datës 08.04.1993.

shkak të vdekjes së nipit me të cilin kanë jetuar në bashkësi të njëjtë familjare dhe ekonomike.²⁰ Edhe këtu, me rastin e caktimit të lartësisë së kompensimit të dëmit jomaterial, duhet të merret për bazë mendimi i ekspertit të mjekësisë nga ana e gjykatës, kur konstatohet vuajtja psikike, intensiteti i saj dhe kohëzgjatja. E drejta e zhdëmtimit të familjarëve lejohet gati në të gjitha legjislacionet, në varësi të rrethanave të rastit konkret. Në bazë të së drejtës komparative dhe të drejtës sonë, duhet të zhdëmtohet jo vetëm humbja e të drejtës për ushqim, por edhe humbja e shpresës dhe parashikimeve më të thjeshta për të ardhmen që mund të kishte fëmija, siç mund të ndodh nga humbja e jetës së prindërve, ku fëmijët fitojnë të drejtën e zhdëmtimit për dëmin e shkaktuar. Person i legjitimuar në këtë rast, mund të paraqitet secili fëmijë, apo edhe bashkëshorti pasjetues.

Shpërblim i dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të frikës

Detyrimi për shpërblimin e dëmit jomaterial lind edhe në rastet e shkaktimit të frikës. Këtë lloj të detyrimit e parasheh edhe legjislacioni i Maqedonisë në dispozitat e LMD-së. Mirëpo, këtu duhet të përmendim se edhe pse disa legjislacione nuk përmbajnë dispozita për shpërblimin e dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të frikës, siç është rasti me legjislacionin shqiptar, në të drejtën anglo-saksone, me të drejtën franceze, austriake, italiane e të tjera, prapëseprapë dëmshpërblimi i tillë përkrahet nga praktikat gjyqësore dhe doktrinën juridike të këtyre vendeve. Frika njihet edhe nga e drejta romake si “metus”, e cila konsiderohej si delikt dhe përfshinte veprimet e paligjshme të dhunës fizike. Frika, paraqet elementin subjektiv të palës së dëmtuar dhe është ndjenjë e shqetësimit të thellë, është përjetim psikik i brendshëm, i pakëndshëm i palës së dëmtuar, që vjen si rezultat i veprimit të dëmshëm të dëmtuesit. Si e tillë, frika mund të shkaktohet edhe pavarësisht lëndimeve trupore dhe dhimbjeve tjera fizike. Pra, frika mund të shkaktohet edhe në raste të tentativës për sulm, edhe kur ushtrohet drejtpërdrejtë dhuna. Frika, varësisht nga rrethanat, mund të paraqitet me intensitetin të ndryshëm, nga më e ulët deri tek më e larta. Por, në të gjitha rastet janë dhe rrethanat e tjera që kanë ndikim në intensitetin e frikës, siç mund të jetë ndjeshmëria individuale e personit dhe kohëzgjatja e frikës.

²⁰ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Shtip, Gzh. nr. 2932/05 të datës 13.01.2006.

Megjithatë duhet theksuar se disa gjendje normale psikike dhe somatike, mund ta zvogëlojnë ndjeshmërinë e dhimbjes (lodhja e tepërt, zgjimi i shpejtë), ose e kundërta, ta rrisin ndjeshmërinë e dhimbjes (i ftohti, pagjumësia). Po ashtu, edhe disa gjendje neuropatike dhe psikike mund të shkaktojnë më shumë ndjeshmëri për dhimbje (neurostenia, hipohondria etj.), apo e kundërta, që ta zvogëlojnë ndjeshmërinë e dhimbjes (alkooli, afekti, shtangia e të tjera).²¹ Kur jemi te frika, këtu eksperti gjyqësor, gjatë përcaktimit të intensitetit dhe kohëzgjatjes së frikës, duhet të marrë për bazë moshën e personit, gjendjen shëndetësore, gjininë e personit, vendin dhe kohën e shkakut të dëmit, e të tjera, pasi efektet nuk janë të njëjta për të gjithë. Këtë e themi, pasi dihet se te fëmijët, te femrat apo te personat me gjendje më të dobët shëndetësore, frika mund të jetë e një intensiteti më të lartë dhe me kohëzgjatje më të madhe se sa tek të rriturit, e cila si e tillë edhe mund të len pasoja. Të gjitha këto rrethana të paraqitura në raportin e ekspertit gjyqësor, i merr për bazë gjykatësi me rastin e vlerësimit të lirë, të formuar sipas bindjes së tij të brendshme me rastin e shpalljes së vendimit. Që të realizohet shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të frikës së pësuar, në mënyrë kumulative duhet të plotësohen këto kushte: të shkaktohet frika e intensitetit të caktuar dhe me kohëzgjatje të caktuar, frika të shkaktojë vuajtje psikike te viktimja dhe të të afërmit e tij, të ekzistojë lidhja kauzale midis frikës së pësuar dhe vuajtjeve psikike të shkaktuara, frika e shkaktuar të jetë rrjedhim i fajit të dëmtuesit dhe duhet të parashtrohet kërkesa për realizimin e shpërblimit të dëmit jomaterial.²² Siç u pa edhe nga kushtet e lartpërmendura, tek ky lloj i shpërblimit të dëmit jomaterial, më me rëndësi është që të vërtetohet vuajtja psikike e shkaktuar si rezultat i frikës, intensiteti dhe kohëzgjatja e saj. Konstatimin për intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës, e cakton eksperti gjyqësor, duke marrë për bazë rrethanat e rastit konkret. Shpërblimi i dëmit të shkaktuar, mund të realizohet, në qoftë se te personi shkaktohet frikë me intensitet dhe kohëzgjatje të caktuar, dhe nga kjo frikë të shkaktohen pasoja të caktuara. Jo për çdo lloj frike jepet shpërblimi i dëmit jomaterial, por vetëm për atë lloj të frikës, e cila krijon pasoja esenciale dhe që manifestohet me trauma psikike. Mirëpo, jo gjithëherë kërkohet që frika të jetë me pasoja të përhershme, por e rëndësishme është që intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës të arsyetojnë shpërblimin e drejtë të dëmit. Në praktikën gjyqësore të Maqedonisë kemi raste të shpeshta të vendimeve gjyqësore për

²¹ Aleksej Duma, Aleksandra Gutevska, vep. e cit., f. 94

²² Alishani Alajdin, vep. e cit., f. 562.

shpërblim të dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të frikës apo dëmeve tjera. Kështu, mund të përmendim vendimin e Gjykatës Themelore Shkup - II, në lidhje me shpërblimin e dëmit jomaterial, me të cilin detyrohet pala e paditur, shoqëria e sigurimeve “Sava Tabak sh.a.”, që paditësit V.A. nga P. t’i paguajë shpërblimin e dëmit jomaterial në vlerë prej 56.000,00 denarë, nga të cilat 17.000,00 denarë për shkaktim të dhimbjes fizike, 12.000,00 denarë për shkaktim të frikës dhe 27.000,00 denarë për shkaktim të dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm për jetesë. Kjo, pasi më 12.12.2008, në ora 20:00, në P., personi M.S. nga P. me veturën e tij “Dacija Llogan”, e siguruar te kompania e lartpërmendur, ka goditur paditësin duke e hedhur jashta rrugës dhe duke u larguar nga vendi i ngjarjes pa mos i ofruar ndihmën e nevojshme personit të lënduar.²³ Apo në një rast tjetër, kur në një fshat malor të Tetovës, me datë 09.09.1998, ariu sulmon personin A.A., i cili ka qenë duke mbledhur thana, me ç’rast i shkaktonte lëndime të rënda trupore. Meqë ariu bën pjesë në kafshët e mbrojtura me ligj, gjuetia ndaj të cilave nuk lejohet, atëherë për dëmet e shkaktuara nga të njëjtat përgjigjet shteti. Si rezultat i kësaj, Gjykata themelore e Tetovës, pas procedimit të lëndës, sjell vendim me të cilin pjesërisht miraton kërkesëpadinë e palës së dëmtuar.²⁴ Lidhur me këtë çështje, pas ankimimit nga pala e dëmtuar, Gjykata e Apelit në Shkup, pas rishqyrtimit të lëndës dhe provave të deponuara, sjell vendim me të cilin miraton në tërësi kërkesëpadinë e palës paditëse A.A., me çka pala e paditur, Republika e Maqedonisë së Veriut, si subjekt përgjegjës, detyrohet që përveç dëmit material, edhe në emër të dëmit jomaterial t’i paguajë palës paditëse shumën prej 200.000,00 denarë (rreth 3.270 euro) për shkaktim të dhimbjeve fizike, shumën prej 100.000,00 denarë (rreth 1.630 euro) për frikën e shkaktuar, shumën prej 300.000,00 denarë (rreth 5.000 euro) për shkaktimin e vuajtjeve psikike për shkak të zvogëlimit të aftësisë për jetë.²⁵ Dëmi jomaterial për këtë rast arrin shumën prej 600.000,00 denarë (rreth 10.000 euro), duke llogaritur dhe kamatën për vonesë nga data e sjelljes së vendimit nga Gjykata Themelore e Tetovës, 01.03.2000, deri në ditën e përmbushjes së detyrimit. Jashtë kësaj shume, gjykata, palës së dëmtuar, i ka miratuar edhe kërkesën për dëm material.

²³ Aktgjykim i Gjykatës Themelore Shkup - II, XXXVIII II. P. nr. 2423/09, datë 01.07.2010

²⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Tetovë, P. nr. 1179/98, i datës 01.III.2000

²⁵ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Shkup, G. Zh. nr. 1179/98 të datës 06.VII.2000.

Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkakimit të shëmtimit

Shpërblimi i dëmit jomaterial mund të kërkohet në rastet kur personit të caktuar i shkaktohen shëmtime apo deformime në pamjen e tij fizike. Me shëmtim apo deformim të pamjes fizike nënkuptojmë atë formë të dëmit jomaterial, që shkaktohet si pasojë e dëmtimit të integritetit trupor të personit të dëmtuar. Shëmtimi paraqet prishjen e pamjes së jashtme, të formës së trupit të njeriut ose të ndonjë pjese të tij, përkatësisht prishjen e pamjes së jashtme të ndonjë funksioni trupor.²⁶ Edhe pse shumica e legjislacioneve nuk përmbajnë dispozita që e rregullojnë në mënyrë shprehimore këtë çështje, prapëseprapë në praktikat gjyqësore të këtyre vendeve njihen mjaft raste të shpërblimit të dëmit jomaterial për shkak të shkakimit të shëmtimit. Janë të shpeshta rastet e shkakimit të shëmtimit të cilat vijnë në shprehje gjatë dëmtimeve të shkaktuara, gjatë lëndimeve në komunikacion, gjatë përdorimit të sendeve të rrezikshme apo gjatë marrjes me veprimtari të rrezikshme, me ç'rast personave të dëmtuar i'u shkaktohen deformime në fytyrë apo në kokë si rezultat i vragëve të krijuara, deformim me rastin e lëndimit apo këputjes së dorës apo këmbës apo dhe të pjesëve tjera të trupit. Pas momentit të deformimit, shkaktohet humbje e bukurisë për personin në fjalë dhe paraqitet çekuilibrim psikik, krijohet një ndjenjë e inferioritetit në raport me anëtarët e tjerë të shoqërisë dhe gjithë kjo situatë reflektohet me gjendje depresive me çka shpeshherë kemi dhe stagnim të të dëmtuarit në profesion apo dhe në jetën e përditshme.

Me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit të dëmit jomaterial të shkakuar nga shkaktimi i shëmtimit, gjykatësi duhet të marrë parasysh profesionin e të dëmtuarit, gjininë, moshën etj., sepse pasojat e shëmtimit nuk janë të njëjta tek të gjithë kategoritë e personave njësoj. Kështu, në qoftë se i lëndohet apo i humbet këmba një futbollisti apo balerini, krahu një basketbollisti, i deformohet fytyra një artisteje, këngëtare apo një femre që merret me reklamimin e modës, atëherë këto raste padyshim që paraqesin vuajtje psikike dhe dhembje shpirtërore të një intensiteti dhe kohëzgjatje më të madhe, sepse paraqesin pengesa esenciale për zhvillim të profesionit të këtyre personave dhe të njëjtat mund të pasojnë me çrregullime psikike. Në të gjitha këto raste, gjykatësi duhet me shumë kujdes të konstatojë përmasat e shëmtimit të çdonjëri individualisht dhe

²⁶ Dauti Nerxhivane, vep. e cit., f. 206.

efektet e tij në çrregullimin dhe vuajtjet psikike që krijojnë për të dëmtuarin. Meqë mund të ndodhë që këto pasoja të jenë të pashmangshme dhe të gjata, andaj personave të dëmtuar me këtë shpërblim të dëmit jomaterial duhet t'iu mundësohet të kenë satisfaksion për vuajtjet që kanë pësuar me shëmtim ose deformim të shkaktuar.²⁷

Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të dhembjes fizike

Gjatë dëmtimeve trupore dhe dëmtimeve të shëndetit për personin normalisht që shkaktohen dhe dhembje fizike. Me dhembje fizike nënkuptojmë mundimin, shqetësimin apo vuajtjen që e provon ta heq dikush kur ka dhimbje në trup si rezultat i ndjenjës së pakëndshme të krijuar nga një vuajtje fizike. Dhimbja fizike paraqitet në rolin e mekanizmit mbrojtës të trupit të njeriut dhe kjo shkaktohet çdoherë kur lëndohet ndonjëra nga pjesët e trupit. Edhe përkundër dallimit që ekziston ndërmjet dhimbjes fizike dhe dhimbjes shpirtërore prapëseprapë të dyja këto kanë shumë elemente të përbashkëta. Të dyja këto janë me element të brendshëm subjektiv, shkaktojnë ndjenjë të pakëndshme dhe krijojnë efekte negative psikike te personi. Sot mjekësia ka arritur që me medikamente mjekësore ta zvogëlojë në minimum dhimbjen fizike të personit me rastin e dëmtimeve trupore, por kjo nuk paraqet ndonjë fakt juridik me rëndësi për personin që të humb të drejtën për tu shpërblyer për dëmin trupor të shkaktuar. Ndalimi i shkaktimit të dhembjes fizike vërehet nga neni 9 dhe neni 142 të LMD-së të Maqedonisë, ku jepet përkufizimi për nocionin e dëmit dhe ndalimi i shkaktimit të dëmit dhe në nenin 189 ku i jepet e drejta gjykatësit të caktojë shpërblimin e dëmit jomaterial në rast të konstatimit të dhembjeve fizike me intensitet të lartë dhe kohëzgjatje më të gjatë, pavarësisht shpërblimit të dëmit material apo mungesës së tij. Dhembja fizike, shkaktohet nga raste të ndryshme të lëndimit trupor, e cila shpeshherë ndodhë edhe nga veprimi i drejtpërdrejtë i personave apo sendeve nga jashtë. Dhembja fizike paraqet një element shumë të rëndësishëm për gjykatësin me rastin e caktimit të shpërblimit të dëmit jomaterial për palën e dëmtuar. Por, për të caktuar një shpërblim të këtillë gjykatësi duhet të bazohet në raportin e ekspertit gjyqësor, i cili duhet ta konstatojë se ajo dhembje jo vetëm që është shfaqur por ka qenë e një intensiteti të lartë dhe me një kohëzgjatje

²⁷ Alishani S. Alajdin, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 1989, f. 763-764.

të caktuar, duke marrë për bazë dhe peshën e të mirave të cenuara me çka duhet të arsyetohet ai shpërblim.

Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkakimit të vuajtjes psikike

Vuajtja psikike gjithashtu paraqet një fakt relevant për shpërblimin e dëmit jomaterial. Vuajtja psikike, paraqet një rrethanë më shumë subjektive të të dëmtuarit, meqë dhe për vetë ekspertin është vështirë të përcaktohet përmasa e saj, pasi shpeshherë varet nga konstruksioni psiqik dhe mentaliteti i të dëmtarit. Vuajtja psikike si bazë kryesore për shpërblimin e dëmit jomaterial paraqet një ndjenjë shqetësimi të thellë, respektivisht përjetim të brendshëm të pakëndshëm që ndodh nën ndikimin e një rreziku të jashtëm, me ç'rast tek personi shkaktohen çrregullime emocionale dhe psikike. Vuajtja psikike si rezultat i dëmit të shkaktuar ndodh në rastet e dëmtimit trupor apo traumatizimeve trupore me pasoja të deformimit të caktuar të njeriut kur shkaktohet invaliditeti i rëndë trupor qoftë të jashtëm apo të brendshëm, kur shkaktohet vdekja e ndonjë të afërmit, në rastet të shëmtimeve trupore, kur shkaktohet frika, të cilat janë raste që në një mënyrë ose tjetër shkaktojnë shqetësim psikik te i dëmtuari. Vuajtja psikike si bazë kryesore për shpërblimin e dëmit jomaterial, paraqet një ndjenjë shqetësimi të thellë, respektivisht përjetim të brendshëm të pakëndshëm që ndodh nën ndikimin e një rreziku të jashtëm, me ç'rast tek personi shkaktohen çrregullime emocionale dhe psikike. Në rast të invaliditetit të rëndë të ndonjë personi, gjykata mund t'u gjykojë bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblim të drejtë në të holla për vuajtjet e tyre psikike (neni 190, pika 3 i LMD-së të Maqedonisë). Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkakimit të vuajtjes psikike, gjithashtu mund të gjykohet edhe për bashkëshortin jashtëmartesor, nëse bashkëjetesa në mes tyre ka ekzistuar për një kohë më të gjatë.

Summary

Non-material damage represents the damage caused by the encroachment of the personal rights of the natural and juridical person. The positive law has determined that non-material damage, should be compensated with moral satisfaction. This can happen in cases when the perpetrator of the damage is asked to apologize, to publish the court decision for guilt announcement, to withdraw the statement with which

the damage was caused, etc. All of these actions can help the victim in restoring the relationship of trust and can be seen as an excuse in front of the world in general for rights encroachment. However, case law accepts compensation of non-material damage only in those cases that are expressly listed in the provisions of the Law on Obligational Relationship and the Law on Civil Liability for Defamation and Insult. Unlike material damage, compensation for non-material damage is more difficult to determine, as the intensity of the encroachment values depends on more than one circumstance.

The request for material compensation for non-material damage may be filed: due to damage of health, bodily injury, fear cause, disfigurement caused, physical pain caused, mental suffering caused, loss of family member etc. Compensation for non-material damage does not have the character of direct reparation of the created consequence, but aims to create a sense of satisfaction for the injured party, creating a satisfaction that has the effect of reducing suffering. This is because in case of non-material damage, the return to the previous state is almost impossible.

In order for the compensation of non-material damage to be realized, all conditions must be met cumulatively: to prove the consequence of the damage to health, from the damage to health to cause non-material damage in the sense of causing mental suffering, from this mental suffering to cause damage to the injured person or mental imbalance, to exist the causal connection between encroachment of health and the damaged caused and a request must be submitted to the court for the realization of compensation for this damage

Recensentë:

Prof. dr. Agim Nuhiu

Doc. dr. Shpresa Alimi-Memedi

Bibliografia:

- Prof. Dr. Alajdin S. Alishani, E drejta e detyrimeve-Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2002.
- Prof. Dr. Aleksandar Nikollovski, Stopansko pravo so osnovi na pravoto, Shkup, 1984.
- A. Sallabanda, E drejta e detyrimeve I, Tiranë, 1961.
- Prof. Dr. Asen Grupçe&Prof. Dr. Strezovski, E drejta e Detyrimeve, Shkup, 1985.

- Dr Boris Vizner, Komentar na Zakonot za Obligacioni Odnosi I, Zagreb, 1978.
- Prof. Dr. Dimitar Pop Georgiev, Obligaciono pravo, Shkup, 1985.
- Gale Galev&Jadranka Daboviq Anastasovska, “Obligaciono pravo”, Shkup, 2009.
- Ivica Crnić, “Odštetno pravo”, Zagreb, 2008.
- Dr. Ivo Puhan, E drejta romake, Prishtinë, 1989.
- Prof. Dr. Kiril Çavdar & Mr. Kimo Çavdar, “Ligji për marrëdhënie të Detyrimeve” - komente, sqarime, praktik gjyqësore dhe regjistri i lëndëve, Shkup, 2008.
- Marjana Pop-Taleska, “Dëmet ndërkombëtare bazuar në kartonin e gjelbërt”, Sigurimi Vardar sh.a., Dëmi jomaterial, Revistë shkencore “AKADEMIK” - Shkup.
- Michel Cannarsa, “Compensation for Personal Injury in France”, Itali.
- Prof. Dr. Mihailo Konstantinoviç, Obligaciono pravo, Beograd, 1959.
- Oliver Antiç, E Drejta e Detyrimeve, Beograd, 2011.
- Reinhard Zimmermann, “THE LAW OF OBLIGATIONS: Roman Foundations of the Civilian Tradition”, Published in the United States by Oxford University Press Inc., New York, 1996.
- Sreten Živković, Naknada imovinske i neimovinske štete, Beograd.
- Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Ligji për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Vendim i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, Rev. nr. 274/93 të datës 08.04.1993.
- Vendim i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, G. Zh. Nr 391/77, të datës 08.12.1977.
- Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Shtip, G. Zh. nr. 2932/05 të datës 13.01.2006.
- Aktgjykim i Gjykatës Themelore Shkup - II, XXXVIII II. P. nr. 2423/09, datë 01.07.2010.
- Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Tetovë, P. nr. 1179/98, i datës 01.III.2000.
- Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Shkup, G. Zh. nr. 1179/98 të datës 06.VII.2000.